



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.13/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas detyrës zyrtare, me datë 10.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHEN hetimet disiplinore ndaj gjyqtarës N.K.M, për shkelje të supozuar disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.15 të Ligjit mbi Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Me datë 11.12.2023, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë A.K, i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë Armend Berisha, me e-mailin zyrtar me titull “Njoftim”, në të cilin ka theksuar se bashkëngjitur po e përcjellë Raportin e hetuesit A.K, të datës 10.12.2023 lidhur me një rast të vrasjes në tentativë ku palë janëdhe K.K., në të cilin ceket se në vend të ngjarjes ka dalë gjyqtarja N.K.M, e cila i ka familjarë të dyshuarit dhe se e njëjta ka dalë në vend të ngjarjes pa ndonjë kërkesë të prokurorit kujdestar. Në e-mailin e tij, i njëjti ka sqaruar se këtë njoftim e ka përcjellë në mënyrë që të vlerësohen veprimet e gjyqtarës. Në vazhdimësi të këtij e-maili, Kryeprokurori K., ka përcjellë e-mailin e hetuesit A.K me titull “Raport Informues” drejtuar prokurores L.V, e-mailin e prokurores L.V drejtuar zyrtarëve policor dhe kryeprokurorit si dhe e-mailin e shefit të SHR – DRP Pejë N.N.

Kryetar i Gjykatës, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kompetent, ka vlerësuar njoftimin e Kryeprokurorit K. dhe ka gjetur se e njëjta nuk përmban elementet e përcaktuara sipas nenit 5 të Rregullores për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve (tani e tutje Rregullorja) andaj, konform nenit 6 par.3 të Rregullores sipas së cilës “*Nëse ankesa nuk përmban elementet e përcaktuara sipas nenit 5 të kësaj Rregullore, mund të trajtohet nga Autoriteti Kompetent sipas detyrës zyrtare, nëse përmbajnë informata bindëse se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore.*”, autoriteti kompetent ka vendosur që pretendimet në fjalë të trajtohen sipas detyrës zyrtare.

Duke vepruar konform nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, autoriteti kompetent e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës se në kuptim të nenit 12 të këtij Ligji, sipas detyrës zyrtare ka filluar mbledhjen dhe vlerësimin e provave për shkelje të mundshme disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.15 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nga gjyqtarja N.K.M.

Me qëllim të vlerësimit të veprimeve të gjyqtarës N.K.M, autoriteti kompetent i është drejtuar me Kërkesë për dhënie të deklaratës shefit të Sektorit të Hetimeve Rajonale në Pejë N.N, hetuesit A.K, krimteknikut A.M dhe hetuesit Q.SH për rrethanat se: *a ka qenë policia dhe prokurori i rastit në vendin e ngjarjes kur ka arrit gjyqtarja, se a ka komunikuar gjyqtarja me zyrtarët policor që kanë qenë në vend të ngjarjes, a i ka udhëzuar gjyqtarja në ndërmarrjen apo mosndërmarrjen e ndonjë*

veprimi të caktuar hetimor në vendin e ngjarjes dhe se a e kanë parë gjyqtaren të ketë komunikuar me zyrtarët policor apo me prokuroren.

Po ashtu, autoriteti kompetent i është drejtuar edhe prokurores L.V., me Kërkesë për dhënie të deklaratës për rrethanat se: *a e ka ftuar e njëjta gjyqtaren N.K.M apo gjyqtarin e procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Pejë për të dalë në vend të ngjarjes natën kritike të datës 10.12.2023, a ka komunikuar gjyqtarja N.K.M me të njëjtën natën kritike, gjatë kohës sa kanë qenë duke kryer veprimet hetimore zyrtarët policor, a ka vënë re apo a ju ka njoftuar ndonjëri nga ta se gjyqtarja ka komunikuar me ndonjërin nga zyrtarët policor, a e ka këshilluar gjyqtarja N.K.M, prokuroren apo ndonjë zyrtar policor në ndërmarrjen apo mosndërmarrjen e ndonjë veprimi të caktuar hetimor në vend të ngjarjes dhe se a është përfshirë gjyqtarja N.K.M në rast duke ndërmarrë veprime si gjyqtare apo cili ka qenë Q.i i saj natën kritike në vendin e ngjarjes.*

Gjithashtu, autoriteti ka marrë deklaratën me shkrim nga gjyqtarja N.K.M lidhur me daljen e saj në vendin e ngjarjes në rastin e datës 10.12.2023.

Kryetari i Gjykatës, duke vepruar brenda kompetencave dhe autorizimeve si autoritet kompetent, me qëllim të vlerësimit për shkelje të mundshme disiplinore nga ana e gjyqtares N.K.M, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar provat si në vijim:

- **E-mailin e datës 10.12.2023, të shefit të SRP – DRP Pejë N.N** drejtuar kryeprokurorit, prokurores dhe eprorëve të tjerë policor, të përcjellë te autoriteti kompetent nga kryeprokurori K., në të cilin i njëjti ka theksuar se ekipi i hetimeve rajonale dhe krimtekniku rajonal janë angazhuar në terren duke udhëhequr me rastin dhe janë duke asistuar edhe hetimet e Stacionit Policor në Pejë ndërsa, lidhur me dështimet e tjera eventuale në sigurimin e vendit të ngjarjes dhe dëshmime të tjera, do të sigurohen raportet e nevojshme të policëve.
- **Deklaratën e dhënë me shkrim me datë 19.12.2023, Shefi i SRP – DRP Pejë N.N**, në pyetjet e parashtruara nga autoriteti kompetent, në të cilën i njëjti ka theksuar se me datë 10.12.2023, rreth orës 03:08 të mëngjesit, nga zyrtarët e Qendrës Operative përmes telefonit është informuar për incidentin që kishte ndodhur ndërsa, natën kritike nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes dhe nuk ka kontaktuar me gjyqtaren N.K.M e as që e ka ditur se e njëjta ka qenë në vendin e ngjarjes.
- **E-mailin e datës 10.12.2023 të prokurores së shtetit L.V** drejtuar zyrtarëve policor dhe kryeprokurorit, të përcjellë te autoriteti kompetent nga kryeprokurori K., në të cilin e njëjta ka theksuar se për rastin e natës kritike është informuar pasi që është kryer vendi i ngjarjes dhe menjëherë ka shkuar në polici dhe ka filluar ndërmarrjen e veprimeve hetimore lidhur me rastin, duke kërkuar po ashtu që të informohet nga zyrtarët policor se për të gjitha veprimet që i kanë ndërmarrë apo nuk i kanë ndërmarrë dhe arsyet e mosndërmarrjes së veprimeve.
- **Deklaratën e dhënë me shkrim me datë 20.12.2023, nga prokurorja L.V**, në pyetjet e parashtruara nga autoriteti kompetent (shih pyetjet më lartë), në të cilën e njëjta ka theksuar se natën kritike të datës 10.12.2023, personalisht si prokurore kujdestare nuk e ka njoftuar gjyqtaren N.K.M e as gjyqtarin kujdestar të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Pejë për të dalë në vendin e ngjarjes, se natën kritike nuk ka komunikuar me gjyqtaren

K.M dhe se e njëjta si prokurore, ka dalë në vendin e ngjarjes kur zyrtarët policor kanë qenë duke kryer veprimet hetimore kurse për rastin është njoftuar pas kryerjes së vendit të ngjarjes nga hetuesi A.K, dhe me t'u njoftuar nga ky i fundit se në vend të ngjarjes ka qenë gjyqtarja N.K.M, ka kërkuar që të dilet përsëri në vendin e ngjarjes në mënyrë që të merren veprimet e tjera urgjente dhe të ketë një pasqyrë lidhur me vendin e ngjarjes. E njëjta, ka theksuar se nuk ka pas komunikim me gjyqtaren dhe sigurisht se nga e njëjta nuk ka marrë asnjë këshillë nga ajo për ndërmarrjen apo mosndërmarrjen e ndonjë veprimi hetimor dhe meqë nuk ka qenë në vendin e ngjarjes kur aty prezent ka qenë gjyqtarja N.K.M, nuk mund të jep konstatim se çfarë Q.i ka pasur ajo natën kritike në vendin e ngjarjes.

- **E-mailin e datës 10.12.2023 të policit A.K, me titull Raporti Informues** drejtuar prokurores L.V, të përcjellë te autoriteti kompetent nga Kryeprokurori K., në të cilin hetuesi mes tjerash ka konstatuar se, citoj “... *Vlen të ceket se në vendin e ngjarjes rreth orës 02:15 derisa ne ishim në vendin e ngjarjes aty janë paraqitur edhe familjarët e familjes K., V K.(nëna e të dyshuarve K.dhe)* së bashku me gjyqtaren N.K.M dhe dy avokatët A.dhe M.K.. *Të njëjtit paraprakisht, na njoftuan verbalisht se ardhja e tyre si rezultat se ata ishin njoftuar nga K.dhe Gj.se kanë pasur një problem në oborrin e objektit të tyre. Nga ana e njësitit të hetimeve në ora 02:45 është njoftuar prokurorja kujdestare...”.*

Lidhur me konstatimin e tij në Raport për paraqitjen e gjyqtares N.K.M në vendin e ngjarjes, autoriteti kompetent hetuesit A.K i është drejtuar me Kërkesë për dhënie të deklaratës për rrethanat se *a ka qenë policia dhe prokurori i rastit në vendin e ngjarjes kur ka arrit gjyqtarja, se a ka komunikuar ajo me zyrtarët policor që kanë qenë në vend të ngjarjes, se a i ka udhëzuar gjyqtarja në ndërmarrjen apo mosndërmarrjen e ndonjë veprimi të caktuar hetimor në vendin e ngjarjes dhe se a e ka parë gjyqtaren të ketë komunikuar me zyrtarët policor apo me prokuroren.*

- **Në deklaratën e tij të dhënë me shkrim me datë 20.12.2023, lidhur me pyetjet e autoritetit kompetent hetuesi A.K,** ka sqaruar se për rastin e datës 10.12.2023, rreth orës 01:25 është njoftuar përmes telefonit nga kolegu i tij, në ora 02:10 ka shkuar në Stacionin Policor, pastaj ka shkuar në vendin e ngjarjes ku ka gjetur hetuesin Q. Sh., krimteknikun A.M dhe patrullën policore dhe nga ta është njoftuar se në vendin e ngjarjes paraprakisht, ishin paraqitur gjyqtarja N.K.M, V. K.dhe dy avokatët A.dhe M.M., ndërsa ka sqaruar se kur ai ka shkuar në vendin e ngjarjes të njëjtit nuk i ka gjetur aty andaj, nuk mund të jep sqarime në pyetjet e parashtruara.

Referuar deklarimeve të hetuesit A.K, autoriteti kompetent i është drejtuar hetuesit Q.SH dhe krimteknikut A. M., me kërkesë për dhënien e deklaratës për rrethanat si më lartë.

- **Polici hetues Q. Sh., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim me datë 26.12.2023,** ka sqaruar se në ngjarjen e datës kritike të datës 10.12.2023, ka qenë së bashku me zyrtarin e krimteknikës A.M dhe rreth orës 02:15, deri sa kanë qenë pothuajse në përfundim të ndërmarrjes së veprimeve hetimore në vendin e ngjarjes, pronë e të dyshuarvedhe K.K., ka ardh gjyqtarja N.K.M e shoqëruar me dy djemtë e saj A.dhe M.M. dhe nënën e të dyshuarve V.K.. Në momentin kur kanë dalë nga vetura kanë reaguuar me shqetësim, e në veçanti nëna e të dyshuarve ka pyetur se çka kishte ndodhur (tekstualisht: Kuku çka mi gjet fëmijët), me ç’rast i njëjti thekson se personalisht ju është afruar dhe i ka njoftuar se ka ndodh një gjuajtje dyshohet nga arma e zjarrit, por nuk ka të plagosur apo të lënduar nga asnjëra palë dhe ka kërkuar nga të njëjtit që të mos shqetësohen, gjithnjë duke u munduar

që situatën ta mbaj nën kontroll duke qenë në dijeni se ata janë familjarë të të dyshuarve duke i vënë theks të veçantë faktit se komunikimi i vetëm ka qenë njoftimi nga ana e tij se aty ka pas gjuajtje dhe nuk ka të lënduar dhe se këtë ja ka thënë nënës së të dyshuarve në prezencë të të tjerëve. I njëjti ka theksuar se në bazë të reagimeve të tyre kishte bindjen se nuk ishin në dijeni se ku dhe kush kishte gjuajtur dhe ka sqaruar se gjatë Q.it në afërsi të vendit të ngjarjes gjyqtarja N.K.M nuk ka dhënë ndonjë udhëzim, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që të ndërhyj apo të pengoj në proces, por qëndrimi i saj ka qenë si familjare, në asnjë moment nuk ka vërejtë se ka reaguuar si gjyqtare apo të ketë ushtruar ndikimin e saj, qëndrimi i tyre ka qenë i shkurtër dhe të njëjtët menjëherë janë larguar nga vendi i ngjarjes duke theksuar se në momentin kur kanë arritur familjarët në vendin e ngjarjes veprimet hetimore pothuajse kishin përfunduar, gjyqtarja nuk ka pas komunikim lidhur me veprimet hetimore apo se si ka ndodhur rasti, as me të e as me kolegun e tij - krim teknikun A. M.. Po ashtu, ka sqaruar se prokurorja nuk ka qenë prezent në vendin e ngjarjes kur ka arritur gjyqtarja me familjarë, nuk ka parë e as nuk ka dëgjuar të ketë pasur kontakt apo bisedë mes gjyqtares dhe prokurores në ndonjë formë, qoftë edhe bisedë telefonike. Përfundimisht, hetuesi Sh. në deklaratën e tij ka theksuar se me përgjegjësi të plotë potencon se nuk ka pas ndërhyrje, nuk ka dhënë asnjë udhëzim se si të veprohet, nuk ka biseduar me asnjë polic hetues apo polic të tjerë prezent në vendin e ngjarjes dhe se sjelljet e gjyqtares kanë qenë si familjare e shqetësuar për rastin që kishte ndodhur.

- **Polici hetues A. M., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim me datë 26.12.2023**, lidhur me pyetjet e autoritetit kompetent sa i përket prezencës së gjyqtares N.K.M në vendin e ngjarjes, ka deklaruar se natën kritike ka qenë duke e proceduar vendin e ngjarjes dhe personalisht nuk e ka parë gjyqtaren N.K.M, pasi ka qenë në brendi të vendit të ngjarjes – brenda shiritave të policisë, pasi edhe pozita e tij është krim teknik dhe ka qenë i fokusuar që në brendi të vendi të ngjarjes të sheh dhe të mbledhë dëshmi të mundshme.
- **E-mailin me titull “Njoftim”, të datës 11.12.2023**, të gjyqtares N.K.M, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Armend Berisha dhe Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Albert Zogaj, e cila përmes këtij e-maili i ka njoftuar të lartcekurit se në mëngjesin e datës 10.12.2023, nga familja është njoftuar se ka ndodh një gjuajtje me armë ku në konflikt kanë qenë të implikuar dy djemtë e vëllait të saj tani të ndjerë, K.K., njëri i mitur dhe tjetri 20 vjeçar, e meqë nëna e tyre jeton në të njëjtën ndërtesë me gjyqtaren dhe nuk kishte njohuri ku i ka fëmijët për të cilën thekson se kujdeset edhe vetë meqë e ka obligim moral, rreth orës 02:00 është nisë së bashku me djemtë e saj dhe me nënën e fëmijëve për të shikuar se ku janë fëmijët dhe çfarë ka ndodhur me ta, pasi familja nuk ka pas as një të vetmin informacion nga policia, duke shtuar se me të arritur te objekti – pronë e fëmijëve në fjalë, në fshatin Vitomericë, aty e kanë gjetë policinë duke kryer vend shikimin dhe nga të njëjtit kanë kuptuar se aty kishte ndodhë një gjuajtje me armë dhe më pas janë larguar dhe se policia vetëm se kanë qenë në përfundim të kryerjes së punëve të tyre. Përfundimisht, ka sqaruar se njoftimin e tillë e bënë pasi e ndjen obligim etik e me qëllim që të mos keqkuptohet shkuarja e saj pasi ka të bëjë me familjarët e saj.
- **Në deklaratën e dhënë me shkrim lidhur me rastin e natës kritike të datës 10.12.2023, gjyqtarja N.K.M** ka theksuar se pretendimi se me datë 10.12.2023, në rastin e vrasjes në tentativë ku të përfshirë janë i mituri ... dhe K.K., ka dal në vendin e ngjarjes pa ndonjë kërkesë të prokurores kujdestare e po ashtu edhe konstatimi në Raportin Njoftues të zyrtarit policor A.K se paraprakisht, i kanë njoftuar verbalisht se shkuarja e tyre ishte si rezultat se kinse ishin

njoftuar nga K.dhe se kanë pasur një problem në oborrin e objektit të tyre, nuk qëndrojnë për arsyet që do të jepen në vijim. Fillimisht, ka theksuar se me përgjegjësi të plotë morale, deklaroi se natën e datës 09.12.2023, rreth orës 22:30, është kthyer nga udhëtimi në Gjermani dhe atë natë ka qenë zgjuar së bashku me familjen e saj deri rreth orës 00:30. Pas rreth një ore, djali i saj A. i ka zgjuar të gjithë, ishte i shqetësuar dhe i ka njoftuar se nga Sh. K.- djali i vëllait të gjyqtarës, ishte informuar përmes telefonit se kishte ndodhë një gjuajtje tek pompa "Sh.", ku të përfshirë ishin i mituri dhe K.K.19 vjeçar. Me të marrë këtë informacion, ishte kontaktuar nëna e fëmijëve, e cila jeton në të njëjtin objekt me gjyqtaren, e cila menjëherë ka ardhur dhe duke mos ditur se çfarë ka ndodhë dhe pasi nuk mund të binte në kontakt me fëmijët, e shqetësuar ju ka thënë se do të shkojë për t'i kërkuar në objekt - pronë e tyre në Vitomerice, ku punonin deri në orët e vona. Meqë ishte pas mesnate, femër e vetme dhe kryefamiljare, gjyqtarja ka sqaruar se kanë provuar ta ndalojnë, me shpresë se do të mund të binte në kontakt me të njëjtin, njëkohësisht nga djali i saj është provuar të kontaktohen D. dhe A. K. por pa sukses, andaj dhe për të mos e lënë të vetme, së bashku me të është nisë vetë gjyqtarja dhe të dy djemtë e saj, për t'i kërkuar fëmijët, duke sqaruar se ka kujdes të veçantë për të njëjtin, si obligim moral që ndjen meqë janë fëmijë të djalit të vëllait të saj të ndjerë. Në deklaratën e saj gjyqtarja ka sqaruar se me të arritur para dyerve të oborrit të objektit, pra tanimë ishte data 10.12.2023, afërsisht rreth orës 02:15, kanë parë se në brendi të oborrit të objektit ishin policia dhe pa e folur asnjëri nga ta ndonjë fjalë, që të katërtit me të shpejtë kanë dalë nga vetura, nëna e fëmijëve ka kap kokën me dorë duke bërë titur "kuku çka u bo, ku i kam fëmijët", pra të njëjtit kanë menduar se ishin gjuajt fëmijët, por një hetues të cilit në ID i shkruante Sh., ju ka dalë përpara dhe ju është drejtuar me fjalët "qetësohuni nuk ka të lënduar, ju lutem mos hyni ngase jemi në përfundim të veprimeve hetimore". Pra, në ato momente e kanë kuptuar se aty kishte ndodhë gjuajtja me armë. Gjyqtarja ka sqaruar se policia kanë marrë një foto të veturës dhe se as gjyqtarja e as familjarët e tjera nuk janë prezantuar se kush janë, e po ashtu nuk ka biseduar me asnjë nga zyrtarët, nuk i ka pyetur për asnjë veprim apo mosveprim të tyre dhe nuk ka kërkuar që të ndërmerret ndonjë veprim dhe se Q.i i tyre ka zgjatë më së shumti deri në 5 minuta. Ndërsa, sa i përket konstatimit të hetuesit A.K, se të njëjtit kanë shkuar në vend ngjarje dhe i kanë informuar se arsyeja e shkuarjes ishte se bazuar në informacionin e marrë nga Gj. dhe K.K.se kishin mosmarrëveshje në objekt, gjyqtarja me përgjegjësi të lartë ka theksuar se ky konstatim është i pabazuar apo thënë më mirë i trilluar, kjo për arsye se hetuesin në fjalë, të cilin ka sqaruar se e njeh, nuk e ka parë fare të ketë qenë atë natë aty prezent. E njëjta ka shtuar se atë natë nuk ka pas kontakt me asnjë nga prokurorët dhe as që ka qenë në dijeni se kush ishte prokuror kujdestar, as që është interesuar ta dijë sepse aty ka shkuar si familjare dhe me të vetmin qëllim të jetë pranë nënës së fëmijëve e cila ishte e shqetësuar dhe nuk kishte kontakt me të njëjtin. Nuk është në dijeni a ka qenë prokurorja e çështjes para se ata të shkonin apo ka shkuar më pas meqë kjo për ta nuk ka qenë me relevancë, për ta ishte me rëndësi të dinin ku janë fëmijët, rrethanë kjo që dokumentohet edhe nga fakti se djali i saj A., ka qëndruar në polici deri në orët e mëngjesit ku prezent aty kishte qenë edhe prokurorja, e i cili vazhdimisht në prezencë të tyre ka provuar t'i kontaktoj fëmijët. Gjyqtarja ka shtuar se natën kritike, nuk ka dalë si gjyqtare, nuk ka pas kërkesë apo njoftim nga prokuroria apo policia për ngjarjen, thjeshtë dalja e saj ka qenë si familjare, me të vetmin qëllim të kërkojnë fëmijët me nënën e fëmijëve. Nuk ka pas asnjë të vetmen bisedë me policinë, lidhur me veprimet hetimore që ata kishin bërë, nuk ka insistuar për asnjë moment të marrë as informacion lidhur me veprimet e tyre dhe se arritja e tyre aty, ishte në përfundim të ndërmarrjes së veprimeve hetimore të policisë, siç edhe i ka njoftuar hetuesi Sh.. Pra, me të kuptuar se çfarë kishte ndodhë aty, janë larguar menjëherë dhe kanë vazhduar kërkimin e fëmijëve edhe në shtëpinë e tyre që e kanë në fshatin Vitomerice. Prandaj edhe e njëjta thekson se një konstatim të tillë të hetuesit A., të potencuar në raport, nuk

e kupton mbi çfarë fakti e ka bazuar, duke kërkuar kështu ballafaqim me secilin që ka qenë prezent në vendin e ngjarjes e të cilët nuk i ka perceptuar se kush janë ngase ka qenë e shqetësuar dhe i vetmi hetues që ka biseduar me ta në hyrje të oborrit të objektit ka qenë hetuesi Sh.. Përfundimisht, gjyqtarja ka theksuar se përfshija e saj nuk ka të bëjë me shkelje të Kodit të Etikës sepse ndjenjat familjare nuk ngurtësohen, e aq më tepër kur nuk ka qenë në dijeni se aty ishte vendi i ngjarjes dhe si gjyqtare nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk ka të bëjë me asnjë të vetmen provë të gjetur apo të pa gjetur, duke shtuar po ashtu se fëmijët për herë të parë ka arritur t'i kontaktoj gjyshi i tyre që ishte jashtë shtetit, e i cili i ka urdhëruar që menjëherë të lajmërohen te organet e rendi, bashkëpunim i cili thekson se nuk ka munguar as nga djali i saj A., për t'iu dhënë ndihmë në çdo kërkesë të hetuesisë.

Autoriteti kompetent me kujdes dhe përkushtim të veçantë analizoj të gjitha deklaratat e mësipërme, si të vetmet prova në këtë procedurë disiplinore në vlerësim të prezencës së gjyqtares në vendin e ngjarjes duke qenë anëtare e familjes së të dyshuarve dhe pas vlerësimit të tyre ka gjetur se natën kritike policia ka qenë në përfundim të mbledhjes së provave në vendin e ngjarjes në kohën kur gjyqtarja është paraqitë aty së bashku me familjarët e saj, kurse prokurorja kujdestare është njoftuar se ka ndodhur rasti pasi zyrtarët policor e kanë kryer vendin e ngjarjes. E njejtja është paraqitë në vendin e ngjarjes, nuk ka biseduar me asnjë nga zyrtarët prezent dhe pasi hetuesi i ka njoftuar se aty ka ndodhë një gjuajtje me armë por nuk ka të lënduar, është larguar. Faktet e tilla u vërtetuan nga deklaratat e zyrtarëve policorë, prokurores së rastit dhe vetë gjyqtares.

Përtej rrethanave të lartcekura, autoriteti kompetent me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetojë se natën kritike gjyqtarja K.M ka shkuar në vendin e ngjarjes duke qenë në dijeni se aty ka ndodhur vepra për të cilën të dyshuar kanë qenë fëmijët e djalit të vëllait të saj, se e njejtja ka komunikuar me zyrtarët policor apo prokuroren e rastit, se e njejtja i ka udhëzuar të njejtit për ndërmarrjen apo mos ndërmarrjen e veprimeve të caktuara hetimore apo përgjithësisht, se e njejtja e ka shfrytëzuar autoritetin e saj si gjyqtare me qëllim të ndikimit në hetimin e kësaj çështje.

Fakti se gjyqtarja K.M dhe dy djemtë e saj paraprakisht i kanë njoftuar zyrtarët policor se ardhja e tyre në vendin e ngjarjes ishte si rezultat i njoftimit nga K.dhe Gj.se ata kishin pas një problem në oborrin e objektit të tyre, ashtu siç është konstatuar në Raportin Informues të përpiluar nga hetuesi A.K, nuk është vërtetuar me asnjë provë, madje i njëjti në deklaratën e tij të dhënë sipas kërkesës së autoritetit kompetent, ka sqaruar se kur ai ka shkuar në vendin e ngjarjes gjyqtaren dhe familjarët e saj nuk i ka gjetur aty, por për faktin se ata kanë qenë prezent në vend të ngjarjes ishte njoftuar nga hetuesi Q.Sh. dhe krimtekniku A. M.. Në anën tjetër, krimtekniku M. me këmbëngulje mohon ta ketë parë personalisht gjyqtaren K.M sepse ka qenë brenda shiritave të policisë i fokusuar në vend të ngjarjes ndërsa, hetuesi Sh. si i vetmi që ka deklaruar se e ka parë gjyqtaren dhe familjarët e saj në deklaratën e tij me detaje sqaron se derisa kanë qenë në përfundim të vendit të ngjarjes ka ardh gjyqtarja e shoqëruar me dy djemtë dhe nënën e të dyshuarve, në momentin e daljes nga vetura kanë reaguuar me shqetësim dhe i vetmi komunikim i tij ka qenë njoftimi i nënës së të dyshuarve se aty ka pas gjuajtje dhe nuk ka të lënduar, duke potencuar me përgjegjësi të plotë se nga ana e gjyqtares nuk ka pas ndërhyrje, e njejtja nuk ka biseduar me asnjë polic prezent dhe sjellja e saj ka qenë si familjare e shqetësuar për rastin e ndodhur.

Nga deklaratat e zyrtarëve policorë, prokurores dhe vetë gjyqtares, në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk u argumentua se gjyqtarja K.M, me paraqitjen e saj në vendin e ngjarjes natën kritike ka ndërmarrë ndonjë veprim, ka ndërhyrë apo ka penguar procesin e hetimit. Përkundrazi, dyshimet e tilla u mohuan nga të gjithë zyrtarët policor të cilët në deklaratat e tyre mohuan të kenë

folur me gjyqtaren apo ta kenë parë atë në vendin e ngjarjes, me përjashtim të hetuesit Sh. i cili në deklaratën e tij mohan në mënyrë kategorike se e njehta ka reaguar, ka ushtruar ndikimin e saj si gjyqtare, ka ndërhyrë, i ka udhëzuar apo ka penguar procesin dhe duke sqaruar se Q.i i tyre në vendin e ngjarjes ka qenë i shkurtër.

Në këtë pikë, autoriteti kompetent vlerësoj parimet e përgjithshme dhe rregullat e sjelljes që dalin nga Kodi i Etikës për Gjyqtar dhe gjeti se me marrjen përsipër të titullit gjyqtar, me të vërtetë që të njejtit si bartës të një funksioni të rëndësishëm publik janë të obliguar që të ruajnë dhe promovojnë sjellje të lartë profesinale, duke u përmbajtur nga sjelljet që ngritin dyshimet e opinionit publik në paanshmërinë apo besueshmërinë e vetë gjyqtarit dhe të gjyqësorit në përgjithësi, megjithatë pavarësisht faktit se gjyqtari pranon kufizimet që i imponon funksioni që ushtron, normat e sjelljes etike që burojnë nga titulli që bartë nuk e zhveshin nga ndjenja njerëzore dhe nga fakti i të qenit familjar.

Andaj, mbi dinamikën e tillë të rrjedhës së ngjarjes së natës kritike, autoriteti kompetent gjeti se me faktin e vetëm të paraqitjes së gjyqtares në vendin e ngjarjes si familjare e shqetësuar dhe largimin e saj të shpejtë nga aty, e në mungesë të provave që vërtetojnë se e njehta ka shkuar në objekt duke e ditur se aty është vendi i ngjarjes, se e njehta ka shfrytëzuar autoritetin e saj si gjyqtare në interes të familjarëve të saj, gjyqtarja N.K.M nuk e ka dëmtuar dinjitetin, pavarësinë apo paanshmërinë e saj apo të gjyqësorit andaj, e njehta nuk është përfshirë në veprime që hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të përcaktuara me nenin 5 par.2 pika 2.15 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD.nr.13/23, me datë 10.01.2024

**Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë
Armend Berisha**

Vendimi i dorëzohet:

- *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- *Gjyqtare N.K.M*